



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 maj 2021
Nr. ref.:RK1776/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI49/21

Parashtrues

Fitim Berisha

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të
autoritetit publik**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fitim Berisha, me vendbanim në Fushë Kosovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike.
4. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) pretendon se i janë cenuar përmes ndonjë akti të një autoriteti publik.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 2 mars 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike parashtroi një shkresë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 3 mars 2021, Gjykata përmes postës elektronike kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë nëse dëshiron që rasti të regjistrohet në Gjykatë, dhe nëse po që të sqarojë kërkesën e tij duke plotësuar formularin e kërkesës.
8. Më 5 mars 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
9. Më 8 mars 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sërish dokumente shtesë.
10. Më 22 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
11. Më 31 mars 2021, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të specifikojë se cilin vendim e konteston, të dorëzojë të njëjtin në Gjykatë dhe të qartësojë para Gjykatës se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë shkelur.

12. Më 1 prill 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike dorëzoi në Gjykatë një shkresë duke përsëritur të njëjtat argumente që i kishte dorëzuar në kërkesën e tij fillestare.
13. Më 12 prill 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë, respektivisht një përgjigje të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.
14. Më 5 maj 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtare raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve të rastit

15. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pohon se çështjet lidhur me procedurën për vërtetimin e kujdestarisë ndaj vajzës së tij kishin qenë të padrejta. Në vijim të kësaj, parashtruesi pohon se duke filluar nga Klinika Gjinekologjike në Prishtinë, Qendra për Punë Sociale në Fushë Kosovë si dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Shëndetësisë, këto të fundit kanë humbur dokumentacionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.
16. Nga shkresat të cilat parashtruesi i ka dorëzuar në Gjykatë, respektivisht nga përgjigja e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, vërehet ndër të tjera se ky i fundit i kishte kthyer përgjigje parashtruesit të kërkesës *“me të gjitha udhëzimet për ndjekjen e procedurave lidhur me kërkesën e tij”*.
17. Në shkresat e lëndës parashtruesi i kërkesës edhe përkundër kërkesave të Gjykatës që të sqarojë kërkesën e tij nuk e ka bërë një gjë të tillë si dhe nuk ka bashkëngjitur asnjë dokument relevant që ndërlidhet me rastin.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës nuk ka kontestuar asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik dhe nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë cenuar përmes ndonjë akti të një autoriteti publik.
19. Parashtruesi i kërkesës në thelb para Gjykatës pretendon se në Klinikën e Gjinekologjisë në Prishtinë, në Qendrën për Punë Sociale dhe në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Shëndetësisë atij i është humbur dokumentacioni që dëshmon se parashtruesi i kërkesës ka të drejtën e kujdestarisë ndaj vajzës së tij të mitur A.B.
20. Parashtruesi në kërkesën e tij thekson *“Unë ndihem shumë i zhgënjyer me këto institucione duke me dëmtuar ne procedura ligjore qe këto deklarata nuk i kane pranuar ne protokolin dhe arkivën te cilën e përcakton ligji ne vendimmarrje e tyre”*.
21. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës, duke pohuar se: *“Unë kërkoj dënim të rëndë dhe kompensim të cilën e përcakton gjykata”*.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

24. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”

(...)

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

25. Në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës së tij, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë në Gjykatë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë nga “autoritetet publike”, pasi të kenë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. I njëjti kriter është po ashtu i përcaktuar në nenin 47 të Ligjit. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë akt të një autoriteti publik që mund të ketë rezultuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të tij.

26. Për më tepër, neni 48 i Ligjit specifikisht detyron parashtruesit e kërkesave që të qartësojnë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë. I njëjti nen, gjithashtu i detyron parashtruesit e kërkesës që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore pretendojnë të jenë cenuar.
27. Në rrethanat e rastit e konkret, parashtruesi i kërkesës: a) as nuk ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston dhe b) as nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon t'i jenë cenuar nga ky akt. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj.
28. Në raste të tilla, të kërkesave të pakompletuara, e të cilat si të tilla rezultojnë në mospërmbyshjen e kriterëve kushtetuese dhe ligjore të pranueshmërisë, Ligji dhe Rregullorja e punës përcaktojnë procedurën që duhet ndjekur nga Gjykata në mënyrë që parashtruesit të kërkesës t'i jepet mundësi për të kompletuar dhe plotësuar kërkesën e tij. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton paragrafin 4, të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit dhe pikat (e) dhe (h) të paragrafit (2) të rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 22
[Procedimi i kërkesës]

“[...]

4. Nëse kërkesa [...] nuk është e [...] kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të [...] plotësuar kërkesën [...].”

[...]

Rregulli 32
[Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve]

“32 (2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(e) mbrojtjen juridike të kërkuar;

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës;

[...].”

29. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se kërkesën e parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar më 5 mars 2021. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, më 31 mars 2021, në pajtim me paragrafin 4, të nenit 22 të Ligjit, Gjykata i kërkoj parashtruesit të kërkesës që të plotësojë kërkesën e tij, duke: a) specifikuar aktet e autoriteteve publike të cilat i konteston; b) qartësuar saktësisht pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë; dhe c) dorëzuar kopjet e dokumenteve dhe informatave të tjera që mbështesin pretendimet e tij.

30. Më 1 prill 2021, parashtruesi i kërkesës është përgjigjur me një shkresë para Gjykatës, duke ripërsëritur të njëjtat argumente si në kërkesën e tij fillestare, por duke mos u përgjigjur në kërkesat e Gjykatës, respektivisht duke mos e saktësuar se cilin vendim e konteston si dhe cilat liri dhe të drejta të mbrojtura me Kushtetutë pretendon se i janë shkelë.
31. Në këtë aspekt, dhe duke marrë parasysh që kërkesa e parashtruesit të kërkesës siç është dorëzuar në Gjykatë, nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj, dhe gjithashtu përkundër kërkesës së Gjykatës, parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar apo qartësuar kërkesën e tij, Gjykata në bazë të Rregullores së saj të punës, mund të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet rregullit 35 të Rregullores, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35

[Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

“35 (5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën, [...]”

32. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i deklaroi këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesit të kërkesës (shih rastin KI48/17, *Sladana Radojković-Marinković*, Gjykata Kushtetuese, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 21).
33. Andaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ashtu siç është kërkuar nga Gjykata, bazuar në nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullin 32 (2) (h) të Rregullores së punës.
34. Prandaj, Gjykata konform nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullit 35 (5) të Rregullores së punës konkludon se kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 5 maj 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi